

## THIRRJE PËR KONKURIM

**A keni ndonjë mendim mbi rolin që mund të luajë vetëqeverisja lokale në riformimin e së ardhmes dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve në komunën tuaj?**

Nëse keni ide interesante se çka duhet të bëjnë institucionet komunale për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike, dhe ngritjen e besimit të qytetarëve, në nivelet e ndryshme të qeverisjes lokale, atëherë kjo është mundësia juaj!

Gara për Ese e të Rinjve organizohet nga OSBE Misioni në Kosovë në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit të Gjakovës, Pejës, Istogut, Klinës, Deçanit dhe Junikut. Gara është një mundësi për nxënësit e klasave të 10-ta dhe 11-ta të ndajnë idetë, pikëpamjet dhe propozimet e tyre për të përmirësuar zhvillimin e institucioneve lokale në komunat përkatëse.

**Java e Esësë e të Rinjve** për përkrahjen e zhvillimit të vetë-qeverisjes lokale për herë të parë bën pyetjen për të rinjtë të përgjigjen:

**Përmes syrit të të Rinjve: zgjidhjet e mija se si të përmirësohet cilësia e jetës dhe e shërbimeve në komunën time**

Përgjigja në pyetjet më poshtë duhet të prek njërën nga këto fusha:

- Masat e zbatueshme për përfshirjen e të rinjve në çështjet komunale.
- Llogaridhënia dhe transparenca në proceset vendim marrëse komunale.
- Mbarëvajtja e drejtë e zgjedhjeve komunale, pjesëmarrja dhe përfaqësimi.
- COVID 19 përballë risive dhe çiltërsisë së komunës për ndryshime.
- Komunë me mjedis të pranueshëm: qëndrueshmëria dhe orientimi afatgjatë.
- Të drejtat e njeriut, larmia kulturore dhe kohezioni shoqëror si forcë shtytëse për zhvillimin komunal.

### Rregullat

- Gara është e hapur për të gjithë nxënësit e moshës 16 dhe 17 vjeç nga komunat: Gjakovë, Istog, Pejë, Klinë, Deçan dhe Junik;
- Fituesit do të caktohen nga Bordi përzgjedhës të përberë nga përfaqësues të Zyrës Rajonale të OSBE-së në Pejë, të drejtorive komunale të arsimit dhe/ose të shkollave të mesme;
- Fituesit do të shpërblehen me dhurata / libra nga OSBE.
- Eseja origjinale dhe me propozime reale dhe të qëndrueshme do të promovohen përmes institucioneve komunale;
- Finalistët do të shpallen në fund të muajit maj.

### Procesi i konkurrimit:

- Eseja duhet përmbaj maksimum 2,000 fjalë;
- Esetë pranohen në gjuhë shqipe;
- Vetëm një punim për konkurrues;
- Eseja duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike në email adresë [art.kupa@osce.org](mailto:art.kupa@osce.org)

- Titulli në subjekt në email duhet të shkruhet: **Gara për Esenë e të Rinjve;**
- Konkurruesi nuk duhet të shkruaj emrin dhe mbiemrin në ne ese, por vetëm në email;
- Autori i eses e ka të drejtën autoriale.